

1. Informacion i përgjithshëm

Shoqëria "WEnerg" sh.a është regjistruar pranë QKR me datë 18.09.2009 me NIPT K92118019L. Organizimi dhe funksionimi i saj rregullohet sipas ligjit nr. 9901 dt 14.04.2008 "Për Tregtarët dhe Shoqëritë tregtare".

Veprimtaria kryesore tregtare e Shoqërisë është planifikim, projektim, financim dhe ndërtim të Hidrocentralit "Dardha" në Pukë si dhe prodhimi i energjisë elektrike.

Kapitali aksionar i Shoqërisë është 46,000,000 lekë i cili zotërohet nga aksionerët e shoqërisë.

Administrator i Shoqërisë është Z. Julien Gerald Emile Roche.

Selia qendrore e saj është në adresen : Bulevardi Dëshmorët e Kombit, Kullat Binjake, Nr. 1, Kati 7, Tiranë.

2. Bazat e përgatitjes së pasqyrave financiare

2.1. Deklarata e pajtueshmërisë

Pasqyrat financiare janë përgatitur në përputhje me Standardet Kombëtare të Kontabilitetit të përmirësuara (SKK) dhe ligjin nr.9228, datë 29 prill 2004 "Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare".

2.2. Bazat e matjes

Pasqyrat financiare janë përgatitur bazuar në koston historike.

2.3. Biznesi në vijimësi

Pasqyrat financiare të Shoqërisë përgatiten mbi supozimin e biznesit në vijimësi, i cili merr parasysh se Shoqëria do të vazhdojë ekzistencën e aktivitetit të saj për një të ardhme të parashikuar.

2.4. Monedha funksionale dhe e paraqitjes

Këto pasqyra financiare janë paraqitur në Lek, e cila është dhe monedha funksionale e Shoqërisë.

2.5. Vlerësime dhe gjykime

Paraqitja e pasqyrave financiare kërkon që manaxhimi i shoqërisë të kryejë vlerësime dhe supozime që ndikojnë shumat e raportuara të aktiveve, detyrimeve dhe aktiveve e detyrimeve të kushtëzuara në datën e pasqyrës së pozicionit financiar, si dhe të ardhurave dhe shpenzimeve të krijuara në periudhën kontabël.

Vlerësimet dhe gjykimet rishikohen vazhdimisht dhe bazohen në eksperiencën e mëparshme dhe faktorë të tjerë duke përfshirë pritshmëritë për ngjarjet e ardhshme të cilat besohen të jenë të arsyeshme në rrethanat aktuale. Në disa raste manaxhimi mbështetet në mendimet e ekspertëve të pavarur. Manaxhimi kryen vlerësime dhe gjykime në lidhje me të ardhmen. Vlerësimet kontabël që rezultojnë sipas përkufizimit, jo gjithmonë do të barazohen me rezultatet aktuale. Vlerësimet dhe supozimet që kanë risk të rëndësishëm për të shkaktuar korrigjime (axhustime) materiale, të vlerave të mbartura të aktiveve dhe detyrimeve janë përshkruar më poshtë:

2.5.1. Zhvlerësimi i llogarive të arkëtueshme

Zhvlerësimi i llogarive të arkëtueshme bazohet në humbjet e vlerësuara të cilat rezultojnë nga pamundësia e konsumatorëve për të paguar detyrimet e tyre. Këto vlerësime bazohen në moshën e llogarive të arkëtueshme dhe eksperiencën e mëparshme në çregjistrimin, vlerësimin e aftësisë paguese të konsumatorëve, si dhe ndryshimet e fundit dhe të pritshme të termave të pagesës së konsumatorëve. Manaxhimi vlerëson në fund të çdo periudhe në rast se ka nevojë për zhvlerësimin e llogarive të arkëtueshme.

2. Bazat e përgatitjes së pasqyrave financiare (vazhdim)

2.5.1. Zhvlerësimi i llogarive të arkëtueshme (vazhdim)

Zhvlerësimi i llogarive të arkëtueshme bazohet në humbjet e vlerësuara të cilat rezultojnë nga pamundësia e klientëve për të paguar detyrimet e tyre. Këto vlerësime bazohen në moshën e llogarive të arkëtueshme dhe eksperiencën e mëparshme në çregjistrimin, vlerësimin e aftësisë paguese të klientëve, si dhe ndryshimet e fundit dhe të pritshme të termave të pagesës së konsumatorëve. Manaxhimi vlerëson në fund të çdo periudhe në rast se ka nevojë për zhvlerësimin e llogarive të arkëtueshme.

2.5.2. Provizionet

Provizionet në përgjithësi kërkojnë një nivel të lartë gjykimi, veçanërisht në rastet e konflikteve gjyqësore. Shoqëria vlerëson mundësinë e krijimit të një detyrimi aktual si rrjedhojë e një ngjarje të shkuar, në rast se mundësia e ndodhjes vlerësohet të jetë më shumë se 50% , në të tilla raste shoqëria provizionon vlerën e detyrimit e cila mund të matet me besueshmëri. Për shkak të nivelit të lartë të pasigurisë, në disa raste mund të ndodhë që vlerësimi mund të mos jetë në të njëjtën linjë me rezultatin e çështjes. Manaxhimi vlerëson në fund të çdo periudhe në rast se ka nevojë për krijimin e provizioneve.

2.5.3. Gjykime dhe vlerësime mbi efektet e pandemisë në parimet e vijmësisë.

Ndërsa situata pandemike COVID-19 ende po evoluon në Shqipëri dhe në mbarë botën, ka pasiguri të lartë mbi shtrirjen e saj në kohën e lëshimit të këtyre pasqyrave financiare. Si pasojë, manaxhimi nuk është në gjendje të vlerësojë me siguri dhe të sigurojë një vlerësim sasior të ndikimit të mundshëm të kësaj pandemie në kompani. Ndërsa masat kufizuese vazhdojnë, volumi i shitjeve, fluksi i parasë, (zhvlerësimi i aktiveve, vlera e drejtë, etj.) dhe fitimi mund të ndikohen. Sidoqoftë, në datën e këtyre pasqyrave financiare, kompania po operon, vazhdon të përmbushë detyrimet e saj në kohën e duhur dhe për këtë arsye vazhdon të zbatojë parimin e vijmësisë në përgatitjen e pasqyrave financiare.

2.6. Krahasueshmëria e informacionit kontabël

Kur është e nevojshme, shifrat krahasuese axhustohen (rregullohen) në konform me ndryshimet në paraqitje në periudhën aktuale raportuese. Ndryshimet janë kryer për të paraqitur më mirë natyrën e biznesit të Shoqërisë. Ato aplikohen retrospektivisht.

3. Politikat Kontabël

Politikat kontabël të mëposhtme janë aplikuar në mënyrë konsistente në të gjitha periudhat e paraqitura në pasqyrat financiare.

3.1. Transaksionet në monedhë të huaj

Transaksionet në monedhë të huaj konvertohen në monedhën funksionale dhe regjistrohen me kursin e këmbimit në datën e transaksionit. Aktivitetet dhe detyrimet monetare në monedhë të huaj në datën e raportimit konvertohen në monedhën funksionale me kursin e këmbimit në datën e bilancit. Fitimi ose humbja nga këmbimi në zëra monetarë është diferenca që vjen nga këmbimi i një numri të caktuar njësisish të një monedhe të huaj në monedhën funksionale me kurse të ndryshme këmbimi në datat e këmbimit. Të drejtat dhe detyrimet jo-monetare në monedhë të huaj konvertohen në monedhën funksionale me kursin e këmbimit të datës së kryerjes së transaksionit ndërsa ato që maten me vlerë të drejtë rikëmbehen në monedhën funksionale me kursin e këmbimit të datës kur është përcaktuar vlera e drejtë. Diferencat që rezultojnë nga kursi i këmbimit kalojnë në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

3. Politikat Kontabël (vazhdim)**3.1. Transaksionet në monedhë të huaj (vazhdim)**

Kursi i këmbimit i monedhave të huaja më 31 dhjetor 2019 dhe 2018 është detajuar si më poshtë:

Kursi i këmbimit	31 dhjetor 2019	31 dhjetor 2018
EUR/Lek	121.77	123.42
USD/ Lek	108.64	107.82

3.2. Instrumentat financiarë

Instrumentat financiarë jo-derivativë përbëhen nga llogari të arkëtueshme, mjete monetare, hua të marra dhe të dhëna dhe llogari të pagueshme.

Instrumentat financiarë jo-derivativë njihen fillimisht me vlerën e drejtë plus çdo kosto transaksioni që lidhet me to, përveç siç përshkruhet më poshtë. Për instrumentat e mbajtur me vlerë të drejtë nëpërmjet fitim/humbjes, kostot e transaksionit kalojnë në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve. Në vijim të njohjes fillestare instrumentat financiarë jo-derivativë maten siç përshkruhet më poshtë.

Një instrument financiar njihet nëse Shoqëria bëhet palë në kushtet kontraktuale të instrumentit. Aktivet financiare çregjistrohen kur skadojnë të drejtat kontraktuale të shoqërisë mbi flukset e parasë së aktivitetit financiar ose kur shoqëria transferon aktivin financiar tek një palë e tretë pa mbajtur kontrollin ose gjithë risqet dhe përfitimet thelbësore të aktivitetit. Blerjet dhe shitjet normale të aktiveve financiare kontabilizohen në datën e transaksionit, që është data në të cilën shoqëria angazhohet të blejë apo të shesë aktivin. Detyrimet financiare çregjistrohen nëse detyrimet kontraktuale të shoqërisë skadojnë, shfuqizohen ose anulohen.

Mjetet monetare

Mjetet monetare përfshijnë arkën, llogaritë rrjedhëse dhe depozitat në të parë me bankat. Për qëllimin e pasqyrës së fluksit të parasë, mjetet monetare përfshijnë depozita me afat me një maturim prej tre muajsh ose më pak që nga data e fillimit.

Llogari të arkëtueshme

Llogaritë e arkëtueshme njihen fillimisht me vlerën e drejtë dhe më pas me kosto të amortizuar duke zbritur humbjen nga zhvlerësimi. Provizionit për zhvlerësimin e aktiveve të arkëtueshme llogaritet kur ka të dhëna se shoqëria nuk do të jetë në gjendje të mbledhë të gjitha detyrimet. Vështirësitë financiare të debitorit, mundësia që debitori të falimentojë ose riorganizimi i tij financiar konsiderohen tregues që llogaritë e arkëtueshme të zhvlerësohen. Shuma e provizionit llogaritet si diferencë midis vlerës së mbetur dhe vlerës aktuale të flukseve të ardhshme të parashikuara të parasë të skontuara me normën efektive të interesit.

Llogari të pagueshme

Llogaritë e pagueshme paraqiten me vlerën e tyre të drejtë dhe më pas me kosto të amortizuar, duke përdorur metodën e interesit efektiv.

Hua të marra dhe të dhëna

Huatë e marra dhe të dhëna njihen fillimisht dhe mbahen në vazhdim me vlerën e tregut, pa përfshirë koston e transaksioneve. Pas njohjes fillestare, huatë e marra dhe të dhëna paraqiten me kosto të amortizuar duke njohur në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve çdo diferencë midis koston dhe vlerës së pagueshme nominale përgjatë periudhës së huamarrjes duke u bazuar (si rregull) në interesin efektiv. Interesat e njohura në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve janë përllogaritur mbi bazën e interesit nominal.

3. Politikat Kontabël (vazhdim)

3.2. Instrumentat financiarë (vazhdim)

Vlera e drejtë

Vlerat e drejta të përlogaritura të mjeteve monetare dhe ekuivalentëve të tyre, të kërkesave për t'u arkëtuar, detyrimeve për t'u paguar dhe huave, përfaqësohen me vlerat e tyre kontabël.

Të tjera

Instrumenta të tjerë jo-derivativë maten me kosto të amortizuar sipas metodës së interesit efektiv, duke zbritur çdo humbje nga zhvlerësimi.

Kapitali aksionar

Kapitali aksionar njihet me vlerën nominale.

Zhvlerësimi i aktiveve financiare

Një aktiv financiar konsiderohet i zhvlerësuar nëse ka të dhëna objektive që tregojnë se një apo disa ngjarje kanë efekte negative në flukset e ardhshme që parashikohet të burojnë nga aktivi.

Një zhvlerësim në lidhje me aktivin financiar, të matur me kosto të amortizuar, llogaritet si diferencë midis vlerës së mbetur dhe vlerës aktuale të flukseve të ardhshme të parashikuara të parasë të skontuara me normën efektive të interesit.

Aktivet financiare të rëndësishme testohen për zhvlerësim në mënyrë individuale. Aktivet e tjera financiare vlerësohen në mënyrë të grupuar, në grupe që kanë karakteristika të ngjashme të riskut kreditor.

Të gjitha humbjet nga zhvlerësimi njihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

Një humbje nga zhvlerësimi rimerrret nëse rimarrja mund të lidhet objektivisht me një ngjarje të ndodhur pas njohjes së humbjes nga zhvlerësimi. Për aktivet financiare të matura me kosto të amortizuar, rimarrja njihet në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

3.3. Inventarët

Inventarët regjistrohen në kontabilitet me kosto. Kosto e marrjes përfshin të gjitha shpenzimet e kryera për ta sjellë inventarin në vendin dhe kushtet ekzistuese. Në rastin e prodhimit të produkteve në kosto përfshihet edhe pjesa respektive e shpenzimeve të përgjithshme duke u llogaritur mbi kapacitetet normale prodhuese. Kosto e inventarit llogaritet duke përdorur metodën e mesatares së ponderuar.

Gjendjet e inventarit janë të vlerësuara në bilanc me koston e tyre historike, duke e konsideruar këtë vlerësim, si vlerën më të ulët midis koston dhe vlerës neto të realizueshme.

i. Njohja dhe matja

Të gjitha aktivet afatgjata materiale paraqiten me kosto duke zbritur zhvlerësimin dhe amortizimin e akumuluar.

Kostoja përfshin shpenzime të cilat lidhen drejtpërdrejt me blerjen e aktivit. Kostoja e aktiveve të vetë-ndërtuara përfshin koston e materialeve dhe punës direkte, çdo kosto tjetër të lidhur drejtpërdrejt me sjelljen e aktivit në gjendje pune për qëllimin e synuar të përdorimit, si dhe koston e çmontimit, heqjes së pjesëve dhe sjelljes në gjendjen e mëparshme të vendndodhjes së aktivit. Shpenzimet kapitale të aktiveve të bëra gjatë ndërtimit kapitalizohen në "Ndërtim në proces" dhe transferohen në kategorinë përkatëse të aktivit kur përfundon ndërtimi tij, nga kur aplikohet amortizimi përkatës sipas kategorisë.

Në rastet kur pjesë të një aktivi afatgjatë material kanë jetëgjatësi të ndryshme, ato kontabilizohen si zëra të ndryshëm (komponentët më të mëdhenj) të aktiveve afatgjata materiale.

Fitimet dhe humbjet nga shitjet, apo nxjerrjet jashtë përdorimit përcaktohen duke krahasuar vlerën e shitjes me vlerën e mbetur dhe këto përfshihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

3. Politikat Kontabël (vazhdim)**3.4. Aktive afatgjata materiale***ii. Kostot e mëpasshme*

Kostoja e zëvendësimit të një pjese të një zëri të aktiveve afatgjata materiale njihet në vlerën kontabël të atij zëri nëse është e mundshme që shoqëria do të realizojë përfitime të ardhshme ekonomike nga përdorimi i pjesës zëvendësuese dhe kostoja e pjesës mund të matet në mënyrë të besueshme. Kostot e shërbimeve të zakonshme të aktiveve afatgjata materiale njihen si shpenzim kur ato ndodhin.

iii. Amortizimi

Amortizimi i aktiveve llogaritet duke përdorur metodën e vlerës së mbetur të amortizimit mbi jetën e vlerësuar të çdo pjese të aktivitetit afatgjatë material duke filluar nga dita e parë e muajit që pason muajin e blerjes. Aktivitetet e marra me qira amortizohen duke marrë për bazë periudhën më të shkurtër midis periudhës së qirasë dhe jetës së dobishme të aktivitetit.

Kategoria e aktiveve	Metoda e Amortizimit	Norma e Amortizimit
Mjete transporti	Vlera e mbetur	20%
Pajisje zyresh	Vlera e mbetur	20%
Pajisje informatike	Vlera e mbetur	25%
Të tjera AAM	Vlera e mbetur	20%

Metoda e amortizimit, jeta e dobishme dhe vlera e mbetur rishikohen në çdo datë raportimi.

iv. Çregjistrimi

Një zë i aktiveve afatgjata materiale çregjistrohet kur ai nxirret jashtë përdorimit apo atëhere kur nuk priten më përfitime ekonomike të ardhshme nga përdorimi apo nxjerrja e tij jashtë përdorimit. Fitimet dhe humbjet në rastin e nxjerrjes jashtë përdorimit të aktiveve afatgjata materiale, përcaktohen sipas shumës së tyre të mbetur dhe merren parasysh në nxjerrjen e rezultatit operativ të vitit.

3.5. Aktivet Afatgjata Jomateriale

Një aktiv jo-material njihet nëqoftëse, e vetëm nëqoftëse: është e mundshme që përfitimet e pritshme ekonomike në të ardhmen që i atribuohen atij aktiviteti do të rrjedhin tek njësia ekonomike; dhe kosto e aktivitetit mund të matet me besueshmëri.

Një njësi ekonomike vlerëson mundësinë e përfitimeve të pritshme ekonomike në të ardhmen duke përdorur supozime të arsyeshme dhe të mbështetura që përfaqësojnë vlerësimin më të mirë të drejtimit të kompletit të kushteve ekonomike që do të ekzistojnë gjatë jetës së dobishme të aktivitetit.

Njësia ekonomike përdor gjykimin për të vlerësuar shkallën e sigurisë bashkëngjitur flukseve të përfitimeve ekonomike në të ardhmen që i atribuohen përdorimit të aktivitetit mbi bazën e evidencës së disponueshme në kohën e njohjes fillestare, duke i dhënë më shumë rëndësi evidencës nga të tretët. Një aktiv jo-material matet fillimisht me koston.

Mbajtja e mëpasshme

Mbas njohjes fillestare, një aktiv jo-material mbartet me koston e tij minus çdo amortizim të akumuluar dhe çdo humbje të akumuluar nga zhvelrësimi.

Aktivitetet jo-materiale të krijuara nga marrëveshja koncesionare janë amortizuar në bazë të periudhës koncesionare.

Aktivitetet e tjera jo-materiale amortizohen me normën 15% mbi koston historike.

3. Politikat Kontabël (vazhdim)

3.5. Aktivet Afatgjata Jomateriale (vazhdim)

3.5.1 Marrëveshjet Konçesionare

Një marrëveshje konçesionare e shërbimeve është një marrëveshje ku një qeveri ose një organ tjetër i sektorit publik (konçesiondhënësi) kontraktton një operator privat për të ndërtuar (ose përmirësuar), përdorur dhe mirëmbajtur aktivet e infrastrukturës së konçesiondhënësit si rrugë, ura, tunele, aeroporte, rrjete të shpërndarjes së energjisë, burje apo spitale. Në këto marrëveshje, konçesiondhënësi kontrollon ose rregullon çfarë shërbimesh duhet të ofrojë operatori duke përdorur aktivet, kujt duhet t'ia sigurojë dhe me çfarë çmimi, dhe gjithashtu kontrollon çdo interes të mbetur domethënë në aktive në fund të afatit të marrëveshjes.

Shoqëria ka njohur aktivet e krijuara nga marrëveshja koncesionare sipas modelit të Aktivit Jomaterial. Operatori duhet të njohë një aktiv jo-material në masën që i jep atij të drejtën (licensën) për t'i tarifuar përdoruesve të shërbimit publik. Operatori duhet fillimisht të masë aktivin jo-material me vlerën e drejtë. Më tej për kontabilizimin e aktivit jomaterial, operatori duhet të zbatojë kërkesat e SKK5 Aktivet afatgjata materiale dhe aktivet afatgjata jomateriale.

3.6. Të ardhurat

Të ardhurat njihen atëherë kur është e mundshme që njësi ekonomike do të ketë përfitime ekonomike në të ardhmen dhe këto përfitime mund të maten me besueshmëri. Të ardhurat maten me vlerën e drejtë të arkëtuar ose të arkëtueshme që merr parasysht shumën e çfarëdo zbritje tregtare, zbritjet për shlyerje të menjëhershme dhe zbritjet e bëra për sasi (vëllim) të blerë.

Shoqëria i njeh të ardhurat kur transmeton energjinë.

3.7. Të ardhurat e tjera të shfrytëzimit

Të ardhurat e tjera të shfrytëzimit paraqesin të ardhurat që përfitohen jo rregullisht gjatë rrjedhës normale të veprimtarisë ekonomike duke përfshirë, fitim/humbjet nga shitja e aktiveve afatgjata materiale dhe jomateriale, fitim/humbjet nga rivlerësimet e aktiveve afatgjate të investuara dhe fitim/humbjet që vijnë nga ndryshimi i kursit të këmbimit përveç diferencave të këmbimit që lidhen me veprimtaritë financiare dhe investuese.

3.8. Qiratë

Qiramarrjet klasifikohen si financiare ose operative që në fillimin e qirasë. Qiratë financiare njihen si aktive dhe detyrime financiare në shkallën më të ulët të vlerës së drejtë të aktivit dhe vlerës aktuale të minimumit të pagesave të qirasë në datën e blerjes. Kostot financiare regjistrohen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve nën termin e qirasë me normat e zbatueshme të interesit mbi balancën e mbetur të detyrimeve. Shoqëria ka qira operative.

3.9. Të ardhurat dhe shpenzimet financiare

Të ardhurat financiare përfshijnë të ardhura interesi nga llogaritë bankare dhe fitime nga kursi i këmbimit që njihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve. Të ardhurat nga interesi njihen mbi bazën e të drejtave të konstatuara duke përdorur metodën e interesit efektiv.

Shpenzimet financiare përfshijnë shpenzime interesi mbi huamarrjet dhe humbjet nga kursi i këmbimit, ndryshimet në vlerën e drejtë të aktiveve financiare të mbajtura me vlerë të drejtë nëpërmjet llogarisë fitim/humbje dhe humbjet nga zhvlerësimi i aktiveve financiare. Kostot e huamarrjes njihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve me metodën e interesit efektiv.

3. Politikat Kontabël (vazhdim)**3.10. Tatimi mbi fitimin**

Tatim fitimi i vitit përbëhet nga tatimi aktual dhe tatim fitimi i shtyrë. Tatim fitimi njihet në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve përveç rasteve kur lidhet me zëra që njihen direkt në kapital, rast në të cilin edhe tatimi njihet në kapital.

Tatimi aktual është tatimi i pritur për t'u paguar mbi fitimin e tatueshem të vitit, duke aplikuar normat tatimore në fuqi në datën e bilancit, si dhe çfarëdolloj rregullimi kontabël të tatimit për t'u paguar në lidhje me vitet e mëparshme. Norma e tatimit mbi fitimin për vitin 2019 është 15% (2018: 15%).

Tatim fitimi i shtyrë përfaqëson diferencën e tatimit mbi fitimit të pagueshëm (apo të rikuperueshëm) në periudhat e ardhshme, i cili përlogaritet për të evidentuar diferencat e përkohshme që krijohen për shkak të aplikimit të parimeve kontabël të ndryshme nga ato tatimore. Tatimi i shtyrë njihet sipas metodës së detyrimeve të bilancit, duke aplikuar normën tatimore në fuqi mbi diferencën ndërmjet aktiveve dhe detyrimeve për qëllime të raportimit financiar dhe vlerave të këtyre aktiveve dhe detyrimeve për qëllime tatimore.

Shoqëria nuk ka burim diferencash të përkohshme për njohjen e tatimit të shtyrë mbi fitimin.

3.11. Fondet për pensione

Shoqëria paguan kontributet ndaj sigurimeve shoqërore e shëndetësore të detyrueshme, që sigurojnë përfitimet për pensione të punonjësve në përputhje me legjislacionin shqiptar. Autoritetet Fiskale janë përgjegjëse për përcaktimin e kufirit minimal ligjor të vendosur për pensionet në juridiksionin përkatës sipas një plani kontributësh pensioni të përcaktuar.

3.12. Transaksionet me palët e lidhura

Palët e lidhura përcaktohen kur një palë kontrollohet nga pala tjetër, ose ka ndikim të rëndësishëm në vendimet e biznesit apo vendimet financiare të palës tjetër. Për qëllime të paraqitjes së pasqyrave financiare, drejtimi i shoqërisë dhe manaxhimi konsiderohen si palë të lidhura.

3.13. Provizionet

Një provizion njihet nëse, si rezultat i një ngjarjeje të shkuar, Shoqëria ka një detyrim ligjor apo konstruktiv, i cili mund të vlerësohet në mënyrë të besueshme dhe do të kërkojë në të ardhmen flukse dalëse parash për shlyerjen e tij. Provizionet përcaktohen duke skontuar flukset e pritshme të ardhshme të parasë me një normë skontimi para tatimit që pasqyron vlerësimet aktuale të tregut për vlerën në kohë të parasë dhe për risqet që lidhen me detyrimin në fjalë. Provizionet rishikohen në çdo datë raportimi dhe nëse nuk ka më gjasa për daljen e ndonjë fluksi parash për shlyerjen e detyrimit, provizionet rimerren.

3.14. Aktivet dhe detyrimet e kushtëzuara

Detyrimet e kushtëzuara nuk njihen në pasqyrat financiare. Ato paraqiten në shënime të pasqyrave financiare për sa kohë që mundësia për një dalje të burimeve që përfshijnë përfitime ekonomike është e largët. Një aktiv i kushtëzuar nuk paraqitet në pasqyrat financiare por paraqitet në shënime për sa kohë ekziston mundësia e hyrjes së përfitimeve ekonomike. Shuma e humbjeve të kushtëzuara njihet si provizion, nëse është e mundshme që ngjarjet e ardhshme të konfirmojnë që një detyrim ka lindur në datën e pozicionit financiar dhe mund të bëhet një vlerësim i arsyeshëm i shumës së humbjes.

3. Politikat Kontabël (vazhdim)

3.15. Riparaqitje

Tabela më poshtë prezanton riparaqitjet e bëra për në 31 dhjetor 2018 në pasqyrën e pozicionit financiar.

	Shënime	31 dhjetor, 2018	Sistemime	31 dhjetor, 2018
AKTIVE				
Aktive afatshkurtra				
Mjete monetare	4	7,966,662		7,966,662
Llogari të arkëtueshme tregtare	5	7,945,522		7,945,522
Llogari të arkëtueshme nga palët e lidhura	6	74,627,140		74,627,140
Të tjera llogari të arkëtueshme	7	40,977,302		40,977,302
Parapagime dhe shpenzime të shtyra	8	2,152,450		2,152,450
Totali i aktiveve afatshkurtra		133,669,076	-	133,669,076
Aktivët afatgjata				
Aktive afatgjata material	9	314,728		314,728
Aktive afatgjata jomateriale	10	732,271,291		732,271,291
Kapital i nënshkruar i papaguar	11	15,435,000		15,435,000
Totali i aktiveve afatgjata		748,021,019	-	748,021,019
Totali i aktiveve		881,690,095	-	881,690,095
DETYRIMET				
Detyrime afatshkurtra				
Hua afatshkurtra	12	45,989,376		45,989,376
Llogari të pagueshme tregtare	13	14,943,962		14,943,962
Llogari të pagueshme ndaj palëve të lidhura	14	8,219,587		8,219,587
Detyrime tatimore	15	3,274,808		3,274,808
Të tjera detyrime	16	2,129,359		2,129,359
Totali i detyrimeve afatshkurtra		74,557,092	-	74,557,092
Detyrime afatgjata				
Hua afatgjata	17	334,683,697		334,683,697
Llogari të pagueshme nga palët e lidhura	18	686,628,682	(32,696,605)	653,932,077
Totali i detyrimeve afatgjata		1,021,312,379	(32,696,605)	988,615,774
Totali i detyrimeve		1,095,869,471	(32,696,605)	1,063,172,866
Kapitali				
Kapitali i nënshkruar	19	46,000,000		46,000,000
Humbje të mbartura		(280,832,135)		(280,832,135)
Fitimi/(humbja) e vitit		20,652,759	32,696,605	53,349,364
Totali i kapitalit		(214,179,376)	32,696,605	(181,482,771)
Totali i kapitalit dhe detyrimeve		881,690,095	-	881,690,095

WENERG SH.A

Shënime e pasqyrave financiare më dhe për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019

(Vlerat janë në Lek)

3. Politikat Kontabël (vazhdim)

3.15. Riparaqitje (vazhdim)

Tabela më poshtë prezanton riparaqitjet e bëra për në 31 dhjetor 2018 në pasqyrën e performancës.

	Shënime	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019	Sistemime	Riparaqitur Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2018
Të ardhura nga aktiviteti i shfrytëzimit	20	97,735,679		97,735,679
Të ardhura të tjera të shfrytëzimit	21	964,861		964,861
Total të ardhura		98,700,540	-	98,700,540
Lënda e parë, materiale të konsumueshme dhe të tjera shpenzime		(31,907,901)	-	(31,907,901)
Lënda e parë, materiale të konsumueshme	22	(25,379,381)		(25,379,381)
Të tjera shpenzime	23	(6,528,520)		(6,528,520)
Shpenzime të personelit	24	(4,690,248)	-	(4,690,248)
Paga dhe shpërblime		(4,611,846)		(4,611,846)
Shpenzime të sigurimeve shoqërore/shëndetësore		(78,402)		(78,402)
Shpenzime konsumi dhe amortizimi	25	(36,470,412)		(36,470,412)
Shpenzime të tjera të shfrytëzimit	26	(240,134)		(240,134)
Shpenzime financiare		6,418,778	32,696,605	39,115,383
Shpenzime interesi dhe shpenzime të ngjashme	27	(46,617,805)	32,696,605 (a)	(13,921,200)
Shpenzime të tjera financiare	28	53,036,583		53,036,583
Fitimi/humbja para tatimit		31,810,623	32,696,605	64,507,228
Shpenzimi i tatimit mbi fitimin	29	(11,157,864)	-	(11,157,864)
Shpenzimi aktual i tatimit mbi fitimin		(11,157,864)		(11,157,864)
Shpenzimi aktual i tatimit të shtyrë				
Fitimi/humbja e vitit		20,652,759	32,696,605	53,349,364
Totali i të ardhurave të tjera gjithpërfshirëse për vitin				
Totali i të ardhurave gjithpërfshirëse për vitin		20,652,759	32,696,605	53,349,364

Në shtator 2018 CN'AIR. Yillad Wenerg ka nënshkruar një marrveshje për mos faturuar më interes për huanë që CN'AIR i ka dhënë Wenerg, që fillon nga janari i 2018.

Në pasqyrat financiare për vitin e mbyllur më 2018 kompania ka regjistruar shpenzime për 32,696,605 ALL dhe detyrime për palet e lidhura në të njëjtën shumë.

Informacioni financiar krahasues për periudhën e mbyllur më 31 dhjetor 2018 janë riparaqitur duke rregulluar të pagueshmet ndaj palëve të lidhura dhe shpenzimet e interest dhe të ngjashme në shumën 32,696,605 ALL.

4. Mjete monetare

Mjetet monetare në arkë dhe bankë detajohen si më poshtë më 31 dhjetor 2019 dhe 31 dhjetor 2018:

	<u>31 dhjetor 2019</u>	<u>31 dhjetor 2018</u>
Mjete monetare në bankë	3,524,289	7,966,662
Në lekë	3,519,177	7,852,837
Në monedhë të huaj	5,112	113,825
	<u>3,524,289</u>	<u>7,966,662</u>

5. Llogari të arkëtueshme tregtare

Llogaritë e arkëtueshme më 31 dhjetor 2019 dhe 31 dhjetor 2018 paraqiten si më poshtë:

	<u>31 dhjetor 2019</u>	<u>31 dhjetor 2018</u>
Klientë	22,876,637	7,945,522
	<u>22,876,637</u>	<u>7,945,522</u>

6. Llogari të arkëtueshme ndaj palëve të lidhura

Llogaritë e arkëtueshme ndaj palëve të lidhura më 31 dhjetor 2019 dhe 2018 paraqiten si më poshtë:

	<u>31 dhjetor 2019</u>	<u>31 dhjetor 2018</u>
Të arkëtueshme nga palët e lidhura	71,696,085	74,627,140
	<u>71,696,085</u>	<u>74,627,140</u>

7. Të tjera llogari të arkëtueshme

Llogaritë të tjera të arkëtueshme më 31 dhjetor 2019 dhe 31 dhjetor 2018 paraqiten si më poshtë:

	<u>31 dhjetor 2019</u>	<u>31 dhjetor 2018</u>
Tatim në burim	2,340,299	2,559,895
TVSH për t'u rimbursuar	28,295,802	38,417,407
Tatimi mbi fitimin	6,332,038	-
	<u>36,968,139</u>	<u>40,977,302</u>

8. Paradhënie dhe shpenzime të shtyra

Në këtë zë janë paraqitur shpenzimet për siguracione të cilat i përkasin periudhave të ardhshme. Parapagimet dhe shpenzimet e shtyra detajohen si më poshtë më 31 dhjetor 2019 dhe 31 dhjetor 2018:

	<u>31 dhjetor 2019</u>	<u>31 dhjetor 2018</u>
Shpenzime të shtyra	2,771,427	2,001,736
Paradhënie për furnizim	200,044	150,714
	<u>2,971,471</u>	<u>2,152,450</u>

9. Aktive afatgjata materiale

	Mobilje dhe orendi	Pajisje informatike	Të tjera	Totali
<i>Kosto</i>				
Gjendja më 1 janar 2018	358,336	623,655	415,083	1,397,074
Shtesa				-
Nxjerrje jashtë përdorimit				-
Gjendja më 31 dhjetor 2018	358,336	623,655	415,083	1,397,074
Shtesa				
Nxjerrje jashtë përdorimit				
Gjendja më 31 dhjetor 2019	358,336	623,655	415,083	1,397,074
<i>Amortizimi i akumuluar</i>				
Gjendja më 1 janar 2018	234,567	496,511	259,424	990,502
Amortizimi i vitit	18,074	52,638	21,132	91,844
Nxjerrje jashtë përdorimit				-
Gjendja më 31 dhjetor 2018	252,641	549,149	280,556	1,082,346
Amortizimi i vitit	14,459	39,479	16,904	70,842
Nxjerrje jashtë përdorimit				-
Gjendja më 31 dhjetor 2019	267,100	588,628	297,460	1,153,188
<i>Vlera neto kontabël</i>				
Gjendja më 31 dhjetor 2018	105,695	74,506	134,527	314,728
Gjendja më 31 dhjetor 2019	91,236	35,027	117,623	243,886

10. Aktive afatgjata jomateriale

	Aktive të krjuara sipas marrëveshjes konçesionare	Të tjera jomateriale	Total
<i>Kosto</i>			
Gjendja më 1 janar 2018	960,926,625	1,780,040	962,706,665
Shtesa	390,228	-	390,228
Nxjerrje jashtë përdorimit	-	-	-
Gjendja më 31 dhjetor 2018	961,316,853	1,780,040	963,096,893
Shtesa	411,108	-	411,108
Nxjerrje jashtë përdorimit	-	-	-
Gjendja më 31 dhjetor 2019	961,727,961	1,780,040	963,508,001
<i>Amortizimi i akumuluar</i>			
Gjendja më 1 janar 2018	193,537,747	909,287	194,447,034
Amortizimi i vitit	36,247,955	130,613	36,378,568
Nxjerrje jashtë përdorimit	-	-	-
Gjendja më 31 dhjetor 2018	229,785,702	1,039,900	230,825,602
Amortizimi i vitit	34,523,721	111,021	34,634,742
Nxjerrje jashtë përdorimit	-	-	-
Gjendja më 31 dhjetor 2019	264,309,423	1,150,921	265,460,344
<i>Vlera neto kontabël</i>			
Gjendja më 31 dhjetor 2018	731,531,151	740,140	732,271,291
Gjendja më 31 dhjetor 2019	697,418,538	629,119	698,047,657

11. Kapitali i nënshkruar i papaguar

Kapitali i nënshkruar i papaguar më 31 dhjetor 2019 dhe 2018 paraqitet si më poshtë:

	31 dhjetor 2019	31 dhjetor 2018
Kapital i nënshkruar i papaguar	15,435,000	15,435,000
	15,435,000	15,435,000

12. Hua afatshkurtra

Huatë afatshkurtra më 31 dhjetor 2019 dhe 31 dhjetor 2018 paraqiten si më poshtë:

	31 dhjetor 2019	31 dhjetor 2018
Pjesa afatshkurtër e huasë afatgjatë OTP Bank	26,957,296	21,807,026
Interesa të përllogaritura	2,273,976	24,182,350
	29,231,272	45,989,376

13. Llogari të pagueshme tregtare

Llogaritë e pagueshme më 31 dhjetor 2019 dhe 31 dhjetor 2018 paraqiten si më poshtë:

	<u>31 dhjetor 2019</u>	<u>31 dhjetor 2018</u>
Furnitorë	16,534,901	14,943,962
	<u>16,534,901</u>	<u>14,943,962</u>

14. Llogari të pagueshme afatshkurtra ndaj palëve të lidhura

Llogari të pagueshme ndaj palëve të lidhura më 31 dhjetor 2019 dhe 31 dhjetor 2018 paraqiten si më poshtë:

	<u>31 dhjetor 2019</u>	<u>31 dhjetor 2018</u>
Detyrime tregtare ndaj palëve të lidhura	13,240,660	7,492,581
Detyrime të tjera ndaj palëve të lidhura	1,229,633	727,006
	<u>14,470,293</u>	<u>8,219,587</u>

15. Detyrime tatimore

Detyrimet tatimore më 31 dhjetor 2019 dhe 31 dhjetor 2018 paraqiten si më poshtë:

	<u>31 dhjetor 2019</u>	<u>31 dhjetor 2018</u>
Detyrime për sigurime shoqërore dhe shëndetësore	22,184	24,971
Detyrime për tatim fitimin	-	3,125,075
Detyrime për tatimin mbi të ardhurat personale	106,287	124,762
	<u>128,471</u>	<u>3,274,808</u>

16. Të tjera detyrime

Detyrimet e tjera më 31 dhjetor 2019 dhe 2018 për Shoqërinë vijnë si më poshtë:

	<u>31 dhjetor 2019</u>	<u>31 dhjetor 2018</u>
Detyrime ndaj punonjësve	2,369,213	2,129,359
Detyrime të tjera	-	-
	<u>2,369,213</u>	<u>2,129,359</u>

17. Hua afatgjata

Huaja afatgjatë e marrë nga banka Societe Generale Albania më 31 dhjetor 2019 dhe 2018 paraqitet si më poshtë:

	<u>31 dhjetor 2019</u>	<u>31 dhjetor 2018</u>
Hua nga banka Societe Generale Albania	334,777,212	334,683,697
	<u>334,777,212</u>	<u>334,683,697</u>

18. Llogaritë e pagueshme ndaj palëve të lidhura, afatgjata

Llogaritë e pagueshme ndaj palëve të lidhura përfaqësojnë vlerën e marrë hua nga Shoqëria mëmë:

	<u>31 dhjetor 2019</u>	<u>31 dhjetor 2018</u>
Hua nga shoqëria mëmë CN' AIR	645,189,669	653,932,077
	<u>645,189,669</u>	<u>653,932,077</u>

19. Kapitali

	<u>31 dhjetor 2019</u>	<u>31 dhjetor 2018</u>
Numri i aksioneve	4,600	4,600
Vlera nominale	10,000	10,000
	<u>46,000,000</u>	<u>46,000,000</u>

Vlera e kapitalit më 31 dhjetor 2019 është 46,000,000 Lekë i zotëruar nga aksionerët Ylliad dhe CN' AIR. 49% e aksioneve zotërohen nga Ylliad dhe 51 % e aksioneve zotërohen nga CN' AIR.

Humbjet e mbartura më 31 dhjetor 2019 janë (227,482,771) Lekë. Humbjet e mbartura më 31 dhjetor 2018 janë (280,832,135) Lekë.

20. Të ardhura nga aktiviteti i shfrytëzimit

Të ardhurat nga aktiviteti i shfrytëzimit detajohen si më poshtë për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019 dhe 31 dhjetor 2018:

	<u>Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019</u>	<u>Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2018</u>
Të ardhura nga shitja e energjisë	74,757,496	97,450,861
Të ardhura të tjera	314,317	284,818
	<u>75,071,813</u>	<u>97,735,679</u>

21. Të ardhura të tjera të shfrytëzimit

Të ardhurat e tjera nga shfrytëzimi për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019 dhe 2018 janë si më poshtë:

	<u>Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019</u>	<u>Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2018</u>
Penalite dhe gjoba të arkëtuara	-	1,249,966
Humbje nga këmbimet valutore nga aktiviteti operativ	127,572	(285,105)
	<u>127,572</u>	<u>964,861</u>

21. Të ardhura të tjera të shfrytëzimit**Rakordimi i të ardhurave me FDP-në**

	<u>31 dhjetor 2019</u>
Qarkullim i tatueshëm	73,385,723
Zbritet tarifa e koncensionarit	1,686,090
Shuma e qarkullimit e korrektuar	75,071,813
Sipas Kontabilitetit	75,071,813
Diferenca	<u>-</u>

22. Lënda e parë dhe materiale të konsumueshme

Shpenzimet për lëndë të para dhe materiale të konsumueshme detajohen si më poshtë për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019 dhe 31 dhjetor 2018:

	<u>Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019</u>	<u>Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2018</u>
Shpenzime manaxhimi	22,129,731	22,941,963
Taksa e koncensionit	2,373,699	2,437,418
	<u>24,503,430</u>	<u>25,379,381</u>

23. Të tjera shpenzime

Shpenzimet e tjera për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019 dhe 31 dhjetor 2018 paraqiten si më poshtë:

	<u>Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019</u>	<u>Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2018</u>
Blerje ujë, energji	314,317	284,818
Qira	2,381,840	2,427,336
Shpenzime mirëmbajtjeje	12,452	-
Taksa të ndryshme	407,300	407,300
Shërbime nga të tretë	704,791	684,643
Shpenzime sigurimi	1,652,583	1,425,833
Shpenzime bankare	51,871	66,726
Shpenzime të tjera	128,440	1,231,864
	<u>5,653,594</u>	<u>6,528,520</u>

24. Shpenzime të personelit

Shpenzimet e personelit detajohet si më poshtë për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019 dhe 31 dhjetor 2018:

	<u>Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019</u>	<u>Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2018</u>
Shpenzime për paga	4,188,902	4,611,846
Shpenzime për sigurime shoqërore e shëndetësore	71,214	78,402
	<u>4,260,116</u>	<u>4,690,248</u>

24.1 Shpenzime të personelit

Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019 shoqëria ka numerin mesatar të punonjësve 3 (31 dhjetor 2018:

3). Struktura e stafit prezantohet më poshtë:

	<u>Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019</u>
Administrator	1
Staf tjetër administrativ	2
	<u>3</u>

25. Shpenzime konsumi dhe amortizimi

Shpenzimet e konsumit dhe amortizimit detajohen si më poshtë për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019 dhe 31 dhjetor 2018:

	<u>Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019</u>	<u>Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2018</u>
Shpenzime amortizimi	34,705,584	36,470,412
	<u>34,705,584</u>	<u>36,470,412</u>

26. Shpenzime të tjera të shfrytëzimit

Shpenzimet e tjera të shfrytëzimit paraqesin gjokat dhe penalitetet për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019 dhe 31 dhjetor 2018:

	<u>Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019</u>	<u>Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2018</u>
Gjoka dhe dëmshpërblime	227,817	240,134
	<u>227,817</u>	<u>240,134</u>

27. Shpenzime interesi neto dhe shpenzime të ngjashme

Shpenzimet e interesit neto detajohen si më poshtë për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019 dhe 31 dhjetor 2018:

	<u>Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019</u>	<u>Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2018</u>
Shpenzime interesi	20,766,653	12,658,159
Të ardhura nga interes	(4,965)	(13,777)
Komisioni Overdraft	1,248,300	1,276,818
	<u>22,009,988</u>	<u>13,921,200</u>

28. Shpenzime të tjera financiare

Shpenzimet e tjera financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019 dhe 2018 detajohen si më poshtë:

	<u>Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019</u>	<u>Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2018</u>
Te ardhura nga kembimet valutore na aktiviteti financiar	(8,742,408)	(53,022,260)
TE ardhura te tjera	-	(14,323)
	<u>(8,742,408)</u>	<u>(53,036,583)</u>

29. Shpenzimi i tatimit mbi fitimin

Përlllogaritja e shpenzimit për tatimin mbi fitimin paraqitet më poshtë për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019 dhe 31 dhjetor 2018:

	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2018
<i>Fitimi para tatimit</i>	(7,418,736)	64,507,228
Total shpenzime të panjohura	20,994,470	12,898,293
Shpenzime per pritje percjellje		
Penalite, gjoba e dëmshpërblime	227,817	240,134
Shpenzime interesi	20,766,653	12,658,159
<i>Fitimi para tatimit (përfshirë shpenzimet e panjohura)</i>	13,575,734	77,405,521
Humbje fiskale e mbartur	-	(3,019,764)
Rezultati tatimor	13,575,734	74,385,757
Tatim fitimi @15%	2,036,360	11,157,864
	(9,455,096)	53,349,364

30. Mardhëniet me palët e lidhura

Balancat me palët e lidhura më 31 dhjetor 2019 dhe 2018 paraqiten si më poshtë:

	31 dhjetor 2019		31 dhjetor 2018	
	Të arkëtueshme	Të pagueshme	Të arkëtueshme	Të pagueshme
Ylliad shpk	-	13,240,660	-	7,492,581
Truen	71,696,085	-	74,627,140	-
Julien Roche	-	1,229,633	-	727,006
CN'AIR France	-	645,189,669	-	686,628,682
	71,696,085	659,659,962	74,627,140	694,848,269

30. Mardhëniet me palët e lidhura

Transaksionet me palët e lidhura më 31 dhjetor 2019 dhe 2018 paraqiten si më poshtë:

	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019		Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2018	
	Shitje	Blerje	Shitje	Blerje
Ylliad shpk		22,129,731		27,530,356
CN'AIR		-		-
	-	22,129,731	-	27,530,356

31. Angazhime dhe pasiguri

Çështje gjyqësore

Gjatë aktivitetit të saj të zakonshëm, Shoqëria mund të përfshihet në pretendime apo veprime të ndryshme ligjore nga palë të treta. Bazuar në opinionin e drejtuesve të Shoqërisë, konkluzioni përfundimtar në lidhje me këto çështje nuk do të ketë efekte negative në pozicionin financiar të Shoqërisë ose ndryshime në aktivet neto të saj. Me 31 dhjetor 2019 shoqëria nuk ka asnjë çështje gjyqësore të hapur kundrejt saj apo nga ajo, që mund të kerkojë rregullime të këtyre pasqyrave financiare.

Detyrimet tatimore

Librat e shoqërisë nuk janë audituar nga organet tatimore për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019. Si rrjedhojë detyrimet tatimore nuk mund të konsiderohen përfundimtare. Detyrime të mundshme që mund të rezultojnë nga një auditim i organeve tatimore nuk mund të maten në mënyrë të besueshme.

32. Ngjarje pas bilancit

Më 11 Mars 2020, Organizata Botërore e Shëndetit e deklaroi koronavirusin (COVID-19) një pandemi. Ndërsa situata është ende duke u zhvilluar në Shqipëri dhe në mbarë botën, ka pasiguri të lartë mbi shtrirjen e saj në kohën e lëshimit të këtyre pasqyrave financiare. Impakti financiar do të njihet nga Kompania gjatë vitit 2020. Menaxhimi do të vazhdojë të monitorojë ndikimin e mundshëm dhe do të ndër marrë të gjitha hapat e mundshëm për të lehtësuar çdo efekt. Menaxhimi e konsideron këtë pandemi si një ngjarje që nuk rregullohet pas datës së raportimit dhe e ka shpallur në shënimet shpjeguese të pasqyrave financiare. Efektet mbi bazën e vijimësisë në përgatitjen e pasqyrave financiare janë shpallur në shënimin 2.5.3 " Gjykime dhe vlerësime mbi efektet e pandemisë në parimet e vijimësisë " të këtyre pasqyrave financiare.

Nuk ka asnjë ngjarje tjetër pas datës së bilancit e cila kërkon rregullime apo shpjegime në këto pasqyra financiare.